

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“HOT CHANGE” SHPK**

Sot më Datë 03.04.2023, themelohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “HOT CHANGE”, sipas parashikimeve të këtij Akt Themelimi.

**NENI 1  
Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Themelohet Shoqëria “Hot Change”.
- 1.2 Shoqëria organizohet në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

**NENI 2  
Themeluesit**

2.1 Ortakë Themeluese e Shoqërisë “Hot Change” Shpk është Znj.Fatmira Hoti, Shtetase Shqiptare, lindur më 14.02.1965 në Pukë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Leternjoftimit ID me Nr.033903777 dhe Nr.Personal G55214072B.

**NENI 3  
Selia e Shoqërisë**

3.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, Rruga “Shejnaze Juka”, Paskuqan, Babrru Qëndër, 1047, Ndërtesa Nr.56, Kati i Pare.

3.2 Shoqëria, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar, ka të drejtë të hapi adresë sekondare në të gjithë territorin e vendit.

**NENI 4  
Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

4.1 Shoqëria do të ushtroj veprimtarinë e saj për një afat kohor të pakufizuar.

**NENI 5  
Objekti i Veprimtarisë**

5.1 Shoqëria do të operojë në fushat e mëposhtme:  
a) Në fushën e veprimtarisë financiare të këmbimeve valutore;  
b) Në fushën e agentit Union Net-Western Union, për transferimin e parave;  
c) Në fushën e shërbimit të pagesave utilitare;

**NENI 6  
Kapitali**

6.1 Kapitali i Shoqërisë është 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë.

6.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga një kuotë e vetme, e cila zotërohet nga Ortakia Themeluese e saj, Znj.Fatmira Hoti.



6.3 Vlera e kontributit të Ortakut Themelues për nënshkrimin e Kapitalit të Regjistruar, është në para dhe është shlyer nga Ortaku tërësisht, përpara regjistrimit të Shoqërisë.

**NENI 7**  
**Organet e Shoqërisë**

7.1 Organet e Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Administratori;

**NENI 8**  
**Asambleja e Përgjithshme**

8.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga Ortaku themelues i saj apo Ortakët që mund të hyjnë më vonë në Shoqëri, përmes pjesëmarrjes në Kapitalin e Regjistruar të saj.

8.2 Cdo Ortak ka të drejtë të marri pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

8.3 Cdo Ortak në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

**NENI 9**  
**Emërimi dhe Kompetencat e Administratorit**

9.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë individ në pozitën e Administratorit të Shoqërisë. Administratori mund të zgjidhet nga rradhët e Ortakëve të Shoqërisë ose jashtë saj.

9.2 Afati i emërit të Administratorit nuk mund të jetë më i gjatë se pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje.

9.3 Administratore e Shoqërisë "Hot Change" Shpk, emërohet Znj.Blerina Hoti, Shtetase Shqiptare, lindur më 05.09.2000 në Shkëlzen dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e Letërnjoftimit ID me Nr.033237707 dhe Nr.Personal K05905093V. Emërimi është për një afat 5 vjecar, me të drejtë rizgjedhje. Afati 5 vjecar fillon nga Data 03.04.2023 deri me Datë 03.04.2028.

**NENI 10**  
**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

10.1 Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Akti Themelimi, kompetente do të jetë Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

10.2 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe Ortakëve të saj, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



**ORTAKU THEMELUES  
FATMIRA HOTI**

Fatmira Hoti  


Ky Akt Themelimi përbëhet nga 3 faqe dhe nënshkruhet në dy kopje origjinale me vlerë të njëjtë, në Tiranë, sot më Datë 03.04.2023.

J